

Tiranë, më 04.04.2022

AKT-THEMELIMI DHE STATUT

I shoqërisë tregtare "Farmaci Pharma S" Sh.P.K.

Mbështetur në ligjin "Nr.9901, datë 14.04.2008", për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare, I ndryshuar , dhe ligjin, 9723 datë 03.05.2007 , "Për Regjistrimin e Biznesit" I ndryshuar dhe formalitet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tij të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi në ortakët: Individë me persona të kufizuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjesi të kufizuar " Farmaci Pharma S , Sh.P.K." me akt- themelimi si vijon;

Formulimi

Neni 1.

Formohet shoqëria tregëtare privat e quajtur " Farmaci Pharma S , Sh.P.K." Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptarë, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarin e sajë ne bazë të këtij akti- themeluës dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themeluës.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare " Farmaci Pharma S , Sh.P.K." do të ketë selinë në Adresën : Rruga "Bulevardi Migjeni , pallati Devi 2000 " , Lagjia 14 Astiri, Tirane, Albania. Shoqëria mund të ndryshoj selin e saj, te hapë zyra perfaqësie , degë , te krijoj filial si brenda ashtu dhe jasht Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakeve të saj.

Objektivi I veprimtarisë

Neni 3.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e :

- Farmaci. import eksport , tregtim me shumicë e pakice medikamentesh, mallera të sektorit farmaceutik industrial, paisje mjeksore dhe ç`do gjë tjetër në fushën e mjeksisë. Import -eksport , grumbullim, përpunim, tregtim me shumicë e pakicë bimesh mjeksore dhe etero-vajore etj ,në këtë fushë.



- Tregtim , import -eksportin, me shumicë dhe me pakicë të mallerave industriale, ushqimore, blegtorale, bujqesore, veshmbathjeve, materialeve ndertimi, automjeteve, makinave, paisjeve hidrosanitare, pllakave, dyerve, mobiljeve (edhe prodhimin e tyre), artikujve kozmetik, lëndëve të përpunuara dhe të pa përpunuera të bimeve medicinale, të lëndës drusore, plastike, duralominit etjer.

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Neni 4.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund të shpërbëhet në ç`do kohë dhe për ç`do lloj shkak.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5.

Kapitali fillestar i shoqërisë " *Farmacii Pharma S, Sh.P.K.*" do të jetë 3.000.000 lekë (TRE MILION LEKE). Numri i kuotave dy, Kapitali është I perbashket i dy ortakeve znj. **Gentila Zenelaj (Bakii)** me 50% (1.500.000L), dhe z. **Ermal Zenelaj** 50% (1.500.000L). Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet.

Drjetimi i Shoqërisë.

Neni 6.

Shoqëria do të drejtohet nga administrator sajë . Administratori caktohet znj. **Gentila Zenelaj (Bakii)**. E cila do të jetë perfaqësuesi ligjorë i shoqëris. Ajo është perfaqësuesi shoqërisë në marrdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota ligjore në drejtimin e saj. Ç`do kontratë do të kryhet prej saj dhe në rast mungese, perfaqesoshet nga nje perfaqesues i paisur me prokure te posaçme, e lëshuar nga ana saj. Mandat i administratorit do të jetë 5 (pesë) vjet me të drejtë riemrimi. Administratori mund të shkarkohet nga detyra përpara mbarimit të mandatit me vëndim te Ortakeve.

Neni 7.

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

Neni 8.

Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të emerojnë dhe administrator të tjerë të vlerave material. Kanë të drejtë të caktoj likujditete për problemet e shoqëris si dhe të pajtojnë të tjerët si Ortakë.



Neni 9.

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10.

Shoqëria ka vlerën e saj me madhesi të zakonëshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11.

Shoqëria deklarohet e kriuar në zbatim të plot të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqëris Tregëtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 12.

Akti-themelimit dhe Statuti u përpilua në tre kopje, për tju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "*Farmaci Pharma S, Sh.P.K.*" .

Ortakët

Ermal Zenelaj



Administratori :Gentila ZENELAJ (Bakiu)

